



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:293527

Datë: 05.06.2024

Numri i dokumentit: 05783203

KF.nr.712/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik NULI, dhe zyrtaren ligjore Amire Jahiri, në kontestin tregtar-administrativ të paditësit “E.X.K.” B.I me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë duke vepruar sipas padisë së paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti – rivlerësim malli, vlerë kontesti 10,000.00 euro, jashtë seance, me datë 05.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET SE ËSHTË TËRHEQUR padia KF.nr.712/23 e datës 22.12.2023 e paditësit “E.X.K.” B.I për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore.

A R S Y E T I M

Paditësi “E.X.K.” B.I. me padinë e datës 22.12.2023 ka iniciuar në këtë Gjykatë kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, me bazë juridike: Anulim Vendimi nr.03.1.7-2023-1327 të datës 13.09.2023 objekt kontesti-rivlerësim malli.

Gjykata me datën 14.03.2024, paditësit “E.X.K.” B.I ia ka dërguar vërejtjen për pagimin e taksës gjyqësore në padi në shumën prej 60.00€, me afat pagese prej 15 ditësh nga dita e pranimit, mirëpo edhe pas pranimit të kësaj vërejtje, pala paditëse nuk e ka paguar taksën gjyqësore në afatin ligjor (provë: fletë kthesa e pranuar nga paditësi “E.X.K.” B.I me datë 15.04.2024).

Në bazë të nenit 253 par. 4 të Ligjit nr. 03/L-006, për Procedurën Kontestimore (LPK-ë), i aplikuar përshtatshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ligji nr. 03/L-202, paditësi ka për detyrë që padisë t’ia bashkëngjit edhe vërtetimin mbi taksën e paguar gjyqësore, ndërsa sipas paragrafit 5,

të po këtij neni, nëse paditësi edhe pas vërejtjes së dërguar nga ana e Gjykatës nuk e paguan taksën gjyqësore, ndërsa nuk ekzistojnë kushtet për lirimin e tij nga pagesa e taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.

Duke marrë për bazë faktin si më lartë se është konstatuar se paditësi edhe përkundër vërejtjes së Gjykatës të pranuar me datë 15.04.2024 sipas fletë kthesës nuk e ka paguar taksën gjyqësore për padi, dhe as nuk ka paraqitur kërkesë për lirim, Gjykata konsideron se janë plotësuar kushtet ligjore për ta konsideruar të tërhequr padinë e paditësit në këtë kontest tregtar-administrativ konform nenit 253, paragrafi 4 dhe 5 të LPK-së, Ligji nr. 03/L-006 i aplikuar përshtatshëm sipas nenit 63, të LKA-së, Ligji nr. 03/L-202, prandaj Gjykata nuk është lëshuar më tej në vendosje sipas padisë.

Duke marrë parasysh të lartcekurat, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 81.C. të Ligjit nr. 04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për ATK-së dhe Procedurat nr.03/L-222, nenit 253, paragrafi 4 dhe 5, të LPK-së i aplikuar përshtatshëm sipas nenit 63 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.712/23 data 05.06.2024

Gj y q t a r i,

Fisnik NULI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.